



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MSH) NR.03/2019 PËR UDHËRRËFYES DHE PROTOKOLE KLINIKE

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MOH) NO.03/2019 FOR CLINICAL GUIDELINES AND PROTOCOLS

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MZ) BR.04/2019 O KLINIČKIM VODIČIMA I PROTOKOLIMA

<p>Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,</p> <p>Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr.04/L-125 Për Shëndetësi (GZ Nr.13/07 Maj 2013), nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011).</p> <p>Nxjerr:</p> <p style="text-align: center;">UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.04/2019 PËR UDHËRRËFYESDHE PROTOKOLE KLINIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktoj strukturën organizative, detyrat, përbërjen e organeve administrative, procedurën për hartimin, revidimin, revokimin, zbatimin dhe monitorimin e Udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike në Republikën e Kosovës.</p>	<p>Minister of Ministry of Health,</p> <p>Pursuant to Article 13 of Law No. 04/L-125 on Health (OG No. 13/07 May 2013), Article 8 paragraph 1.4 of Regulation No. 02/2011 on the areas of administrative responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries as well as Article 38 paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011 (Official Gazette No. 15, 12.09.2011),</p> <p>Issues this:</p> <p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO.04/2019 ON CLINICAL GUIDELINES AND PROTOCOLS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this Administrative Instruction is to define the organizational structure, to the duties, composition of administrative bodies, the procedure for drafting, revision, revocation, implementation and monitoring of Clinical Guidelines and Protocols in the Republic of Kosovo.</p>	<p>Ministar Ministarstva Zdravstva,</p> <p>U skladu sa članom 13 Zakona Br. 04/L-125 o zdravstvu (Službeni list, Br. 13/07, maj 2013. godine), članom 8, podstavom 1.4 Uredbe Br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, kao i sa članom 38, stavom 5 Poslovnika o radu Vlade Br. 09/2011 (Službeni list Br. 15 od 12.09.2011. godine).</p> <p>Donosi:</p> <p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO BR.04/2019 O KLINIČKIM VODIČIMA I PROTOKOLIMA</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Cilj ovog Administrativnog uputstva jeste da odredi organizacionu strukturu, da dužnosti i sastav upravnih organa, postupak sastavljanja revizije i opoziva, sprovođenje i praćenje kliničkih vodiča i protokola u Republici Kosovo.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimtaria</p> <p>1.Udhërrëfyesit dhe protokolet klinike zbatohen në Institucione shëndetësore publike, private dhe publiko-private, në të gjitha nivelet e kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor shëndetësor.</p> <p>2.Çdo institucion shëndetësor ofron shërbime shëndetësore për gjendje të caktuara shëndetësore duke u bazuar në Udhërrëfyesit dhe protokolet klinike të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>1.Clinical guidelines and protocols are implemented in public, private and public-private health institutions at all levels of primary, secondary and tertiary health care.</p> <p>2.Each health institution provides health services for health conditions based on the Guidelines and Clinical Protocols approved by the Ministry of Health.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Polje delovanja</p> <p>1.Kliničke vodiče i protokole sprovode javne, privatne i javno- privatne zdravstvene ustanove na svim nivoima primarne, sekundarne i tercijarne zdravstvene nege.</p> <p>2.Svaka zdravstvena ustanova pruža zdravstvene usluge za određena zdravstvena stanja, na osnovu Kliničnih vodiča i protokola koje odobri Ministarstvo zdravstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1.Termt e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Audit klinik (AK) – proces i vlerësimit të cilësisë që ka për qëllim përmirësimin e kujdesit ndaj pacientit, përmes rishikimit sistematik të kujdesit krahasuar me kritere të qarta si dhe vlerësimi i zbatimit të ndryshimeve.</p> <p>1.2. Konflikti i interesit - gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës specifike si pjesëmarrës në procesin e hartimit dhe zhvillimit të Udhërrëfyesve klinik (UK)-ve dhe protokoleve klinike (PK) dhe interesave private të pjesëmarrësit, kur ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, te cilat ndikojnë, mund te ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit të tij përkatës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Terms used in this administrative instruction have the following meanings:</p> <p>1.1. Clinical Audit (CA) - a quality assessment process aimed at improving patient care through systematic review of care in comparison to clear criteria and assessment of the implementation of changes.</p> <p>1.2.Conflict of Interest - the state of disagreement between a specific duty as a participant in the process of drafting and developing the Clinical guidelines (CG) and Clinical Protocols (CP) and the private interests of the participant when it has direct or indirect private, personal or property interests affecting it, may influence or appear to affect its transparency, objectivity and impartiality in the exercise of its function.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi korišćeni u ovom Administrativnom uputstvu, imaju ovo značenje:</p> <p>1.1Klinička revizija (KR) – proces ocene kvaliteta čiji je cilj poboljšanje nege pacijenta, putem sistematskog razmatranja nege u poređenju sa jasnim kriterijumima kao i ocena sprovođenja izmena.</p> <p>1.2. Konflikt interesa – stanje neusaglašenosti između specifične dužnosti kao učesnika u procesu sastavljanja i razvijanja Kliničkih vodiča (KV) i kliničkih protokola (KP) i i privatnih interesa učesnika, kada ima direktnih ili indirektnih privatnih ili imovinskih interesa, koji mogu uticati na transparentnost, njegovu objektivnost i nepristrasnost tokom vršenja njegove određene funkcije.</p>

1.3. Mjekësia e bazuar në dëshmi - shfrytëzimi i hulumtimeve të dëshmuara më të mira të momentit, në mënyrë të vetëdijshme, eksplicite dhe të matur, në procesin e vendim-marrjes rreth kujdesit për pacientin.

1.4. Protokol klinik kombëtar (PKK) – dokumente që përdoren për zbatimin e UK për kujdes shëndetësor specifik në institucione shëndetësore;

1.5. Procedurë standarde operative (PSO)- set i udhëzimeve të shkruara të cilat aplikohen për një aktivitet në një institucion shëndetësor, duke mos u kufizuar vetëm në nivel klinik;

1.6. Udhërrëfyes klinik (UK) – deklarata të cilat përfshijnë rekomandime me qëllim të optimizimit të kujdesit ndaj pacientit, përmbajnë informata nga një rishqyrtim sistematik i dëshimve dhe i vlerësimit të përfitimeve dhe dëmeve të qasjeve të ndryshme në kujdesin shëndetësor;

Neni 4 Struktura Organizative

- 1.Këshilli Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokole klinike (KKUPK).
- 2.Grupet për Adaptimin e Udhërrëfyesve klinik (GAUK).
3. Grupet për hartimin e Protokoleve klinike kombëtare (GHPK)

1.3. Evidence Based Medicine - using the best-proven, well-informed, explicit, and well-informed research in the decision-making process about patient care.

1.4. National Clinical Protocol (NCP) – documents used to implement CG for specific health care in healthcare institutions;

1.5. Standard Operating Procedure (SOP) - set of written instructions that apply to an activity in a health institution, not limited to the clinical level;

1.6.Clinical Guidance (CG) – statements which include recommendations in order to optimize patient care, containing information from a systematic review of proof and assessment of benefits and harms of different approaches to health care;

Article 4 Organizational Structure

- 1.Kosovo Council on Clinical Guidelines and Protocols (KCCGP).
- 2.Groups for the Adaptation of Clinical Guidance (GACG).
- 3.Groups for developing national clinical protocols (GNCP)

1.3.Medicina zasnovana na dokazima – korišćenje dokazanih i trenutno najboljih istraživanja, svesno, eksplicitno i odmereno u procesu odlučivanja u vezi nege pacijenta.

1.4. Nacionalni Klinički protokol (NKP)- dokumenti koji se koriste za implementaciju KV o specifičnoj zdravstvenoj nezi u zdravstvenim ustanovama;

1.5.Standardni operativni postupci (SOP) – skup pisanih vodiča koje se primenjuju za jednu aktivnost u jednoj zdravstvenoj ustanovi, ne ograničavajući se samo na klinički nivo;

1.6.Klinički vodiči (KV) – izjave koje obuhvataju preporuke u cilju optimizovanja nege prema pacijentu, koje sadrže informacije sistematskog razmatranja dokaza i ocene koristi i šteta raznih pristupa zdravstvenoj nezi;

Član 4 Organizaciona struktura

- 1.Kosovski savet za kliničke vodiče i protokole (KSKVP).
- 2.Grupe za adaptaciju kliničkih vodiča (GAKV).
- 3.Grupe za daptaciju kliničkih protokola (GAPK).
- 4.Komisija za ocenu metodologije sastavljanja kliničkih vodiča i protokola (KOMSKVP).

4.Komisioni për Vlerësimin e Metodologjisë së Hartimit të Udhërrëfyesve dhe Protokoleve klinike (KVMHUPK).

5. Rishqyrtuesit kolegial.

Neni 5
Këshilli Kosovar për Udhërrëfyes dhe protokole klinike (KKUPK)

1.Këshilli Kosovar për Udhërrëfyes dhe protokole klinike përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë:

1.1 Një përfaqësues/e nga Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor (DZHSSH) në cilësinë e Kryesuesit/es;

1.2.Një përfaqësues/e nga Fondi për Sigurime Shëndetësore (FSSH);

1.3.Një përfaqësues/e nga Inspektorati Shëndetësor;

1.4. Një jurist/e nga Ministria e Shëndetësisë;

1.5. Një përfaqësues/e nga Divizioni i Farmacisë;

1.6. Një përfaqësues/e nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKSHPK);

1.7.Një përfaqësues/e nga Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës;

1.8. Një përfaqësues/e nga Divizioni për Kujdesin Parësor Shëndetësor;

4.Commission for Assessment of Methodology of Drafting Clinical Guidelines and Protocols (CAMDCGP).

5.Peer reviewers.

Article 5
Kosovo Council on Clinical Guidelines and Protocols (KCCGP)

1.Kosovo Council for Clinical Guidelines consists of 11 (eleven) members:

1.1. A representative from the Department for Strategic Health Development (DSHD), in the capacity of Chairperson;

1.2. A representative from the Health Insurance Fund (HIF);

1.3.A representative from the Health Inspectorate;

1.4.A lawyer from the Ministry of Health;

1.5 A representative from the Pharmacy Division;

1.6. A representative from the National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK);

1.7 A representative from the Faculty of Medicine of the University of Prishtina;

1.8 A representative from the Division for Primary Health Care;

5. Kolegijalni razmatračii.

Član 5
Kosovski Savet za Kliničke Vodiče i Protokole (KSKVP)

1.Kosovski Savet za Kliničke Vodiče i Protokole (KSKVP) sastoji se od 11 (jedanaest članova):

1.1 Jednog predstavnika/ce iz Odeljenja za strateški zdravstveni razvoj (OSZR), u svojstvu predsedavajućeg;

1.2.Jednog predstavnika/ce iz Fonda za zdravstveno osiguranje (FZO);

1.3.Jednog predstavnika/ce iz Inspektorata zdravstva;

1.4. Jednog pravnika/ce iz Ministarstva zdravstva;

1.5. Jednog predstavnika/ce iz Divizije finansija;

1.6.Jednog predstavnika/ce iz Nacionalnog Instituta za Javno Zdravlje Kosova (NIJZK);

1.7.Jednog predstavnika/ce iz Medicinskog fakulteta Univerziteta u Prištini;

1.8 Jednog predstavnika/ce Divizije za primarnu zdravstvenu negu;

<p>1.9. Një përfaqësues/e nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK);</p> <p>1.10.Një përfaqësues/e nga Oda e mjekëve të Kosovës;</p> <p>1.11.Një përfaqësues/e nga Shoqatat për të Drejtat e Pacientëve.</p> <p>2.Ministri emëron anëtarët e KKUPK në bazë të propozimeve të bëra nga institucionet e përcaktuara në nenin 5, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm;</p> <p>3.Këshillit i sigurohet asistencë profesionale dhe administrative nga Divizioni i Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore;</p> <p>4. Mandati i anëtarëve të KKUPK është 4 (katër) vite, me të drejtë të rizgjedhjes.</p>	<p>1.9.A representative from the Kosovo University Hospital and Clinical Service (KUHCS);</p> <p>1.10. A representative from the Chamber of Physicians of Kosovo;</p> <p>1.11. A representative from the Patient Rights Associations.</p> <p>2.The Minister appoints the members of the KCCGP based on proposals made by the institutions set forth in Article 5, with request from Secretary-General;</p> <p>3.The Council is provided with professional and secretarial assistance from the Division of Quality of Health Services;</p> <p>4. Mandate of KCCGP members is 4 (four) years, eligible for re-election.</p>	<p>1.9.Jednog predstavnika/ce iz Univerzitetske kliničko – bolničke službe Kosova (UKBSK);</p> <p>1.10.Jednog predstavnika/ce iz Lekarske komore Kosova;</p> <p>1.11.Jednog predstavnika/ce iz Udruženja za prava pacijenata.</p> <p>2.Ministar imenuje članove KSKVP-a na osnovu predloga ustanova koje su navedene u članu 5, na zahtev generalnog sekretara;</p> <p>3.Savetu se obezbeđuje profesionalna i sekretarska asistencija od strane Divizije za Kvalitet Zdravstvenih Usluga;</p> <p>4. Mandat članova KSKVP-a je četvorogodišnji (4 godine), s pravom na ponovni izbor.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Detyrat dhe përgjegjësitë e KKUPK</p> <p>1.Shqyrton, analizon dhe vlerëson nevojat për hartim, revidim dhe revokim të Udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike (UK dhe PKK);</p> <p>2.Harton dokumentet për zhvillimin e procesit të hartimit të UK dhe PKK , sipas nevojës;</p> <p>3.Aprovon Doracakun për metodologjinë e zhvillimit të UK-ve si dhe dokumentet tjera për zhvillimin e procesit të UK dhe PKK, sipas nevojës;</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Duties and Responsibilities of KCCGP</p> <p>1.Reviews, analyses and assesses the needs for drafting, revision and revocation of Clinical guidelines and protocols (CGP);</p> <p>2.Drafts the documentation for the development of the CG, as needed;</p> <p>3.Approves the Manual on CG Development Methodology as well as other documents for the development of the CG Process, as needed;</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Dužnosti i odgovornosti KSKVP-a</p> <p>1.Razmatra, analizira i ocenjuje potrebu za izradom, revizijom i opozivom Kliničkih vodiča i protokola (KVP);</p> <p>2.Sastavlja dokumenta za razvoj postupka KV, po potrebi;</p> <p>3.Usvaja Priručnik o metodologiji razvoja KV-a kao i ostalih dokumenata za razvoj postupka KV, po potrebi;</p>

<p>4.Propozon Sekretarit të Përgjithshëm kryesuesin dhe anëtarët e GAUK, në bazë të propozimeve nga institucionet shëndetësore relevante, sipas termave të referencës të përcaktuara nga KKUPK;</p> <p>5.Harton dhe miraton Termat e Referencës për Grupet e punës për hartimin e UK-ve dhe PK-ve, të KVMHUPK-ve dhe rishqyrtesve kolegial;</p> <p>6.Harton dhe miraton Rregulloren e punës së KKUPK-së;</p> <p>7.Propozon Ministrin të Shëndetësisë revokimin e UK-ve dhe PK-ve të cilët nuk janë të vlefshëm apo të cilët për arsye tjera ndikojnë në cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe siguri të pacientëve;</p> <p>8.Këshillon Ministrin e Shëndetësisë dhe grupet e tjera të interesit lidhur me çështje që kanë të bëjnë me UK dhe PK;</p> <p>9.Mban takime të rregullta në baza tremujore dhe më shpesh nëse është e nevojshme.</p>	<p>4.Proposes to the Secretary-General the Chairperson and GACG members, on the basis of proposals from the relevant health institutions, according to the terms of reference determined by the KCCGP;</p> <p>5.Drafts and approves the Terms of Reference for the Working Groups for drafting CGs and CPs, the CAMDCGP and Peer Reviewers;</p> <p>6.Drafts and approve the Rules of Procedure for KCCGP;</p> <p>7.Proposes to the Minister of Health the revocation of CGs and CPs which are not valid or which for any other reasons affect the quality of health services and patient safety;</p> <p>8.Advise the Minister of Health and other stakeholders on matters pertaining to the CG and the CP;</p> <p>9.Holds regular meetings on a quarterly basis and more often if necessary.</p>	<p>4.Predlaže generalnoom sekretaru, predsedavajućeg i članove GAKV-a, na osnovu predloga od strane relevantnih zdravstvenih ustanova, u skladu sa mandatom utvrđenim od strane KSKVP-a;</p> <p>5. Sastavlja i odobrava projektne zadatke za radne grupe za izradu KV-ova i KP-ova, za KOMSKVP i kolegijalne razmatrače;</p> <p>6. Sastavlja i usvaja Poslovnik o radu KSKVP-a;</p> <p>7. Predlaže ministru zdravstva opoziv KV-ova i PK-ova koji ne važe ili koji iz drugih razloga utiču na kvalitet zdravstvenih usluga i bezbednost pacijenata.</p> <p>8. Savetuje Ministra Zdravstva i ostale interesne grupe o pitanjima koje se odnose na KV i PK;</p> <p>9. Održava redovne sastanke svaka tri meseca ili češće ukoliko je potrebno.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Roli mbikëqyrës i KKUPK</p> <p>1.KKUPK në cilësinë e mbikëqyrësit sigurohet që të bëjë:</p> <p>1.1 mbikëqyrjen e zbatimit të UK-ve dhe PK-ve në institucione shëndetësore;</p> <p>1.2 mbikëqyrjen e punës së Komisionit për Vlerësimin e metodologjisë së hartimit të të UK-ve dhe PK-ve (KVMHUPK);</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Monitoring Role of KCCGP</p> <p>1.KCCGP in the monitoring capacity ensures to:</p> <p>1.1 monitor the CG implementation based on monitoring reports from the Quality Division of the Ministry of Health;</p> <p>1.2 monitor the work of the CG Quality Assessment Commission (CAMDCGP);</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Uloga nadgledača KSKVP-a</p> <p>1.KSKVP u svojstvu nadgledača osigurava:</p> <p>1.1 nadgledanje sprovođenja KV na osnovu izveštaja o praćenju Divizije za kvalitet u Ministarstvu zdravstva;</p> <p>1.2 nadgledanje rada Komisije za ocenu kvaliteta KV-a (KOMSKVP);</p>

<p>1.3 mbikëqyrjen e punës së GAUK;</p> <p>1.4 rishikimin periodik dhe përditësimin e UK-ve të miratuara, çdo 3 (tre) vite apo më herët nëse ka dëshmi të reja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Detyrat e Sekretarisë në procesin e zhvillimit të UPK-ve</p> <p>1.Sekretaria ka këto detyra:</p> <p>1.1 Asiston Këshillin në identifikimin e temave të mundshme për adaptim të UK përmes kërkimit të literaturës dhe databazave vendore dhe ndërkombëtare;</p> <p>1.2 Në bashkëpunim me Këshillin bën kërkime, identifikon dhe shqyrton dëshmitë në dispozicion, përfshirë edhe UK dhe PPK potenciale për adaptim;</p> <p>1.3 Asiston Këshillin në ofrimin e trajnimeve për metodologjinë e adaptimit të UPK për hartuesit e tyre, sipas planit të punës së KKUPK;</p> <p>1.4 Siguron menaxhimin e integruar të proceseve të adaptimit të UK dhe ofron përkrahje teknike të GAUK gjatë adaptimit të tyre;</p> <p>1.5 Përgatit verzionin e adaptuar për secilin udhërrëfyes për pacientë/popullatë, kur është e mundur;</p> <p>1.6 Menaxhon procesin e botimit dhe publikimit të UK-ve dhe PKK-ve;</p>	<p>1.3 monitor the work of GACG;</p> <p>1.4 do periodic revision and update of approved CGs, every 3 (three) years or earlier if there is new evidence.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Duties of the Secretariat in the Development Process of CGPs</p> <p>1.The Secretariat has the following duties:</p> <p>1.1 Assists the Council in identifying possible topics for CG adaptation through domestic and international literature and databases research;</p> <p>1.2 In cooperation with the Council, it does research, identify and review available evidence, including potential adaptation of CG and NCP;</p> <p>1.3 Assist the Council in providing training on the methodology for adapting CPG to their drafters, according to the KCCGP work plan;</p> <p>1.4 Provides integrated management of CG adaptation processes and provides GACG technical support during their adaptation;</p> <p>1.5 Prepare the adapted version for each patient/population guideline whenever possible;</p> <p>1.6 Manages the publishing and publication process of the CGs and NCPs;</p>	<p>1.3 nadgledanje rada GAKV-a;</p> <p>1.4.periodično razmatranje i ažuriranje KV-ova koji su usvojeni, svake 3 (tri) godine ili ranije ukoliko ima novih dokaza.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Dužnosti Sekretarijata u postupku razvijanja KVP-ova</p> <p>1.Sekretarijat ima ove dužnosti:</p> <p>1.1 Pomaže Savetu u identifikaciji mogućih tema za adaptiranje KV kroz istraživanja domaće i strane literature i baze podataka;</p> <p>1.2 U saradnji sa Savetom istražuje, identifikuje i razmatra dostupne dokaze, uključujući potencijalne prilagodbe KV-a i NKP.</p> <p>1.3 Pomaže Savetu u pružanju obuke o metodologiji prilagodavanja sastavljačima KPV-a, u skladu sa radnim planom KSKVP-a;</p> <p>1.4.Obezbeđuje integrisano upravljanje procesima prilagodavanja KV i tehničku podršku GAKV-a tokom njihovog prilagodavanja ;</p> <p>1.5 Priprema prilagodavanu verziju za svaki vodič pacijentima/stanovništvu, kada je moguće;</p> <p>1.6 Upravlja postupkom izdavanja i objavljivanja KV-ova i NKP-ova;</p>
---	--	---

1.7 Arkivon dokumentet që e dëshmojnë procesin e plotë të zhvillimit të UK-ve dhe PKK-ve, prej emërimit të grupit deri në aprovim.

1.8 Me kërkesë të KKUPK, e dërgon draftin e UK dhe PKK në KVMHUPK, për vlerësim.

1.9 Sekretaria emërohet me vendim të Sekretarit të përgjithshëm;

1.10 Sekretaria përbëhet nga 3 (tre) anëtarë/e, dy anëtarë/e nga Ministria e Shëndetësisë dhe 1 (një) anëtar/e nga Instituti Kombëtar i Shëndetit publik të Kosovës.

Neni 9

Grupi për Adaptimin e Udhërrëfyesve klinik

1.GAUK formohen për secilin UK me vendim të Sekretarit të përgjithshëm gjatë tremujorit të fundit të secilit vit kalendarik për Planin Vjetor dhe sipas nevojës;

2.Secili GAUK përbëhet nga së paku 6 (gjashtë) anëtarë të cilët përfaqësojnë institucione të ndryshme relevante me temën e udhërrëfyesit;

3.Secili GAUK udhëhiqet nga Kryesuesi/ja;

4.Të gjithë anëtarët e GAUK duhet të posedojnë ekspertizë profesionale dhe shkencore në temën e UK-ve të cilin e adaptojnë/revidojnë;

5. Të gjithë anëtarët, para fillimit të punës në grup, duhet të trajnohen për metodologjinë e adaptimit të UK, të aprovuar nga KKUPK

1.7 Archives documents demonstrating the full development process of CGs and NCPs, from group appointment until approval.

1.8 Upon request by KCCGP, it submits the draft of CG and NCP to CAMDCGP for assessment.

1.9 The secretariat is appointed by decision of the Secretary-General;

1.10 The Secretariat consists of 3 (three) members, two members from the Ministry of Health and 1 (one) member from the National Institute of Public Health of Kosovo.

Article 9

Group for Adaptation of Clinical Guidelines

1.GACG are established for each CG by a decision of the Secretary-General during the last quarter of each calendar year for the following Annual Plan and as needed;

2.Each GACG is composed of at least 6 (six) members representing different institutions relevant to the topic of the guideline;

3.Each GACG is chaired by the Chairperson;

4.All GACG members should have professional and scientific expertise on CG topics that they adapt/revise;

5.All members, prior to commencement of group work, should be trained on the CG adaptation methodology, approved by KCCGP.

1.7 Arhivira dokumente koje dokazuju o potpunom postupku razvoja VK-ova i NKP-ova, od imenovanja grupe do odobrenja.

1.8 Na zahtev KSKVP-a, šalje nacrt KV-a o NKP-a u KOMSKVP za procenu.

1.9 Sekretarijat se imenuje odlukom generalnog sekretara;

1.10 Sekretarijat se sastoji od 3 (tri) člana, dva člana iz Ministarstva zdravstva i 1 (jedan) član iz Nacionalnog Instituta za Javno Zdravlje Kosova.

Član 9

Grupa za adaptiranje kliničkih vodiča

1.GAKV se formiraju za svaki KV odlukom generalnog sekretara u poslednjem tromesečju svake kalendarske godine za Plan naredne godine i po potrebi i;

2.Svaka GAKV se sastoji od najmanje 6 (šest) članova koji predstavljaju razne relevantne institucije na temu vodiča;

3.Svakom GAKV rukovodi predsedavajući/a;

4.Svi članovi GAKV treba da imaju profesionalnu i naučnu ekspertizu na temu KV-a koji adaptiraju/revidiraju.

5. Svi članovi, pre početka rada u grupi, trebaju biti obučeni za metodologiju prilagođavanja KV-a, koji usvaja KSKVP.

<p style="text-align: center;">Neni 10 Detyrat dhe përgjegjësitë e GAUK</p> <p>1.GAUK janë përgjegjëse për hartimin e UK-ve në përputhje me metodologjinë e hartimit dhe kohën e përcaktuar nga KKUPK.</p> <p>2. GAUK dorëzon dokumentet shtesë nga takimet e mbajtura, procesverbalet dhe listat e pjesëmarrjes gjatë takimeve të mbajtura, komentet e recenzentëve dhe rishqyrtuesve kolegial dhe versionin origjinal të UK-ve të adaptuar te Sekretaria e KKUPK.</p> <p>3. GAUK e dorëzon draftin final të UK për rishqyrtim kolegial dhe konsultim publik më së largu 4 (katër) muaj nga takimi i parë konstituiv;</p> <p>4. GAUK i adreson komentet nga rishqyrtimi kolegial dhe konsultimi publik, e finalizon dhe nënshkruan UK-në brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve prej përfundimit të afatit të konsultimeve, dhe e dërgon te KKUPK;</p> <p>5. GAUK në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh i adreson komentet e KVMHUPK dhe e dërgon prapë për rivlerësim final.</p> <p>6. GAUK e përgatit PK, pas miratimit të UK gjegjësisht nga Ministri.</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Duties and Responsibilities of GACG</p> <p>1.GACG are responsible for designing the CGs in accordance with the methodology for development and time set by the KCCGP.</p> <p>2.GACG submits additional documents from meetings held, minutes and attendance lists during meetings held, reviewers and peer reviewers' comments and the original CG version adapted to the KCCGP Secretariat.</p> <p>3.GACG submits CG final draft for reconsideration and public consultation at least 4 (four) months from the first constitutive meeting;</p> <p>4. GACG addresses the comments from the Peer Reviewers and Public Consultation, finalizes and signs the CG within 15 (fifteen) days of the end of the consultation deadline, and sends it to KCCGP;</p> <p>5. GACG within 15 (fifteen) days addresses the comments of CAMDCGP and sends it back for final re-assessment.</p> <p>6. GACG prepares CP after the approval of the CG by the Minister.</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Dužnosti i odgovornosti GAKV-a</p> <p>1.GAKV su odgovorne za sastavljanje KV-ova u skladu sa metodologijom pripreme i vremenom koje je odredio KSKVP.</p> <p>2.GAKV predaje dodatna dokumenta sa održanih sastanaka, zapisnike i liste učesnika na održanim sastancima, komentare recezenata i kolegijalnih razmatrača, kao i originalnu verziju KV-ova koji su adaptirani u Sekretarijat KSKVP-a.</p> <p>3. GAKV podnosi konačni nacrt KV-a na kolegijalno razmatranje i javne konsultacije, najkasnije 4 (četiri) meseca od održavanja prvog konstitutivnog sastanka;</p> <p>4.GAKV adresira komentare sa kolegijalnog razmatranja i javne konsultacije, finalizuje i potpisuje KV u roku od 15 (petnaest) dana od okončanja roka za konsultacije i šalje ga KSKVP-u.</p> <p>5.GAKV u roku od 15 (petnaest) dana adresira komentare KOMSKVP-a i šalje ih nazad na konačnu procenu.</p> <p>6.GAKV priprema KP nakon usvajanja određenog KV-a od strane ministra.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit/ses të GAUK</p> <p>1.Kryesuesi/ja përkujdeset për mbarëvajtjen e procesit të adaptimit të UK;</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Duties and Responsibilities of GACG Chairperson</p> <p>1.The Chairperson takes care of the progress of the CG adaptation process;</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Obaveze i odgovornosti predsedavajućeg GAKV-om</p> <p>1.Predsedavajući/a obezbeđuje razvoj proces prilagodavanja KV-a;</p>

- 2.Kryesuesi/ja është përgjegjës për përmbajtjen e draftit të UK;
- 3.Kryesuesi/ja është përgjegjës për dokumentimin e procesit të zhvillimit të UK-ve dhe PKK-ve dhe të rishqyrtimit të tyre.

**Neni 12
Rishqyrtimi kolegial**

- 1.Drafti i UK nga GAUK rishqyrtohet nga së paku 2 (dy) rishqyrtues kolegial;
- 2.Rishqyrtuesit kolegial janë ekspertë në fushën e temës së UK, të emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe të propozuar nga KKUPK, të cilët veprojnë në cilësi të ekspertit individual dhe jo si përfaqësues të institucionit bazuar në kriteret e përcaktuara nga KKUPK.
3. Procesi i rishqyrtimit kolegial duhet të përfundojë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e pranimit të draftit.

**Neni 13
Konsultimet publike**

- 1.Drafti i UK publikohet në faqen zyrtare të MSh-së për konsultime publike;
- 2.Sekretaria e KKUPK e dërgon draftin te përfaqësuesit e shoqatave të pacientëve, Odat e profesionistëve dhe shoqatave relevante me temën e UK të cilët duhet të konsultohen gjatë procesit;

- 2.The Chairperson is responsible for the content of the CG draft;
- 3.The Chairperson is responsible for documenting the development process of CGs and NCPs and reviewing them.

**Article 12
Peer Review**

- 1.The CG draft from GACG is reviewed by at least 2 (two) peer reviewers;
- 2.Peer Reviewers are experts in the field of CG topic, appointed by the Secretary General and proposed by the KCCGP, acting in the capacity of an individual expert rather than as representative of the institution based on the criteria established by the KCCGP;
3. The peer review process should be completed within 15 (fifteen) days, from the date of receipt of the draft.

**Article 13
Public Consultations**

- 1.The CG draft is published on the MoH official website for public consultations;
- 2.The KCCGP Secretariat sends the draft to the representatives of Patient Associations, Chambers of Professionals and Associations relevant to the CG topic who should be consulted during the process;

- 2.Predsedavajući/a je odgovoran za sadržaj nacrtu KV-a;
- 3.Predsedavajući/a je odgovoran za dokumentovanje procesa razvoja KV-a i NKP-a i njihovog razmatranja.

**Član 12
Kolegijalno razmatranje**

- 1.Nacrt KV-a iz GAKV-a razmatra najmanje 2 (dva) kolegijalnih razmatrača;
- 2.Kolegijalni razmatračići su stručnjaci u oblasti teme KV-a koje imenuje generalni sekretar, a apredlaže KSKVP, koji deluju kao pojedinaćni stručnjaci, a ne kao predstavnici institucije, na osnovu kriterijuma koje odredi KSKVP.
3. Proces kolegijalnog razmatranja treba da se završi u roku od 15 (petnaest) dana, od dana prijema nacrtu.

**Član 13
Javne konsultacije**

- 1.Nacrt KV-a se objavljuje na službenoj stranici MZ-a radi javnih konsultacija.
- 2.Sekretarijat KSKVP-a šalje nacrt predstavnicima udruženja pacijenata, komorama profesionalaca i relevantnim udruženjima na temu KV-a koji treba da se konsultuju tokom procesa;

<p>3. Sekretaria e KKUPK i përcjell GAUK komentet eventuale;</p> <p>4. Kryesuesi i GAUK është përgjegjës për adresimin e komenteve nga rishqyrtimi kolegjial dhe konsultimet publike dhe reflektimin e tyre në UK final.</p> <p>5. Procesi i konsultimit duhet të përfundojë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të draftit.</p>	<p>3.The KCCGP Secretariat conveys to GACG eventual comments;</p> <p>4.The GACG Chairperson is responsible for addressing comments from the peer review and public consultations and their reflection in the final CG.</p> <p>5.The consultation process should be completed within 15 (fifteen) days of the publication of the draft.</p>	<p>3.Sekretarijat KSKVP-a prosleđuje GAKV-u eventualne komentare.</p> <p>4.Predsedavajući GAKV-om je odgovoran za adresiranje komentara sa kolegijalnog razmatranja i javnih konsultacija i za njihovo reflektovanje u konačnom KV-u.</p> <p>5. Proces konsultovanja mora da se završi u roku od 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja nacрта.</p>
<p style="text-align: center;">Neni14 Komisioni për Vlerësimin e metodologjisë së hartimit të Udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike (KVMHUPK)</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Commission for Assessment of Methodology of Drafting Clinical Guidelines and Protocols (CAMDCGP)</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Komisija za ocenu metodologije sastavljanja kliničkih vodiča i protokola (KOMSKVP)</p>
<p>1.KVMHUPK është përgjegjës për vlerësimin e metodologjisë së adaptimit dhe transparencën e procesit të zhvillimit të UPK-ve;</p> <p>2.KVMHUPK përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë;</p> <p>3.Kryesuesi dhe anëtarët e KVMHUPK, emërohen nga Sekretari i përgjithshëm, me propozim të KKUPK;</p> <p>4.KVMHUPK i raporton Kryesuesit të KKUPK-së;</p> <p>5.Mandati i Anëtarëve të KVMHUPK është 4 (katër) vite;</p> <p>6. KVMHUPK e realizon detyrën duke e shfrytëzuar instrumentin AGREE II (Rishikimi i Udhërrëfyesve me qëllim Hulumtimi dhe Vlerësimi).</p>	<p>1.CAMDCGP is responsible for assessing the adaptation methodology and transparency of the CGP development process;</p> <p>2.CAMDCGP consists of 5 (five) members;</p> <p>3.Chairperson and members of CAMDCGP are appointed by the General Secretary upon proposal of KCCGP;</p> <p>4.CAMDCGP reports to the Chairperson of KCCGP;</p> <p>5. The mandate of CAMDCGP members is 4 (four) years;</p> <p>6.CAMDCGP performs the task using the instrument AGREE II (Appraisal of Guidelines for Research and Evaluation).</p>	<p>1.KOMSKVP je odgovorna za ocenu metodologije adaptacije i transparentnost procesa razvoja KVP-ova.</p> <p>2.KOMSKVP se sastoji od 5 (pet) članova;</p> <p>3.Predsedavajućeg i članove KOMSKVP-a imenuje Generalni sekretar na predlog KSKVP-a.</p> <p>4. KOMSKVP izveštava predsedavajućem KSKVP-a.</p> <p>5. Mandat članova KOMSKVP-a je 4 (četiri) godine.</p> <p>6.KOMSKVP obavlja zadatak koristeći instrument AGREE II (Razmatranje vodiča u cilju istraživanja i ocene).</p>

<p>7. KVMHUPK e vlerëson draftin e UK të dorëzuar nga Sekretaria e KKUPK, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit;</p> <p>8.KVMHUPK në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve bën rivlerësimin dhe e dërgon te KKUPK për procedim të mëtejshëm.</p> <p>9.KVMHUPK vlerëson PKK të nxjerrur nga UK për përmbajtje të njejtë me UK.</p>	<p>7. CAMDCGP evaluates CG draft submitted by the Secretariat of KCCGP within 15 (fifteen) days from the day of receipt;</p> <p>8.CAMDCGP, within 15 (fifteen) days, re-evaluates and sends it to KCCGP for further proceeding.</p> <p>9.CAMDCGP evaluates the NCP extracted from CG for same content with CG.</p>	<p>7.KOMSKVP ocenjuje nacrt KV-a koji je Sekretarijat dostavio KSKVP-u u roku od 15 (petnaest) dana od dana prijema.</p> <p>8.KOMSKVP u roku od 15 (petnaest) dana ponovo ocenjuje i šalje ga KSKVP-u na dalje procesiranje.</p> <p>9.KOMSKVP ocenjuje NKP koji je pripremljen iz KV-a, za isti sadržaju kao i u KV-u.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Konflikti i interesit</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Conflict of Interest</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Konflikt interesa</p>
<p>1.Të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hartimit dhe të zhvillimit të UK-ve dhe PKK-ve (KKUPK, GAUK, GHPK, rishqyrtuesit kolegial dhe KVMHUPK) duhet të deklarohen lidhur me konfliktin e interesit, përmes nënshkrimit të Deklaratës së Konfliktit të interesit.</p> <p>2. Deklaratat e Konfliktit të interesit prezantohen te anëtarët e KKUPK, të cilët diskutojnë nëse konflikti i deklaruar mund të rezultojë në mungesë të pavarësisë dhe paanshmërisë dhe nëse ky deklarim ndikon në përjashtimin e anëtarit prej pjesëmarrjes në procesin e hartimit dhe zhvillimit të UK-ve dhe PKK-ve.</p> <p>3.Vendimi lidhur me Deklaratat e Konfliktit të interesit merret në KKUPK, me shumicë votash.</p> <p>4.Deklaratat e Konfliktit të interesit nga ana e rishqyrtuesve kolegial prezantohen në GAUK, sipas procedurës së njejtë nga pika 3 dhe 4 e këtij neni.</p>	<p>1.All participants in the CG and NCP drafting and development process (KCCGP, GACG, NCPG, peer reviewers and CAMDCGP) must declare in relation to the conflict of interest through the signing of the Conflict of Interest Declaration.</p> <p>2. Conflict of Interest Declarations are presented to KCCGP members who discuss whether declared conflict could result in a lack of independence and impartiality and whether this statement affects the exclusion of a member from participating in the CG and NCP drafting and development process.</p> <p>3.Decision regarding the Conflict of Interest Declarations is taken by KCCGP, by majority vote.</p> <p>4.Conflicts of Interest Declarations by Peer Reviewers are presented to the GACG, in accordance with the same procedure from point 3 and 4 of this Article.</p>	<p>1.Svi učesnici u procesu sastavljanja i razvijanja KV-a i NKP-a (KSKVP, GAKV, GNKP, kolegijalni razmatrači i KOMSKVP) treba da se izjasne u vezi konflikta interesa potpisivanjem Izjave o konfliktu interesa.</p> <p>2.Izjave o konfliktu interesa se predstavljaju članovima KSKVP-a koji raspravljaju o tome da li izjavljeni konflikt interesa može da rezultira nedostatkom nezavisnosti i nepristrasnosti i da li ta izjava utiče na izučivanje člana od učešća u procesu sastavljanja i razvoja KV-a i NKP-a.</p> <p>3.Odluku o Izjavama o konfliktu interesa donosi KSKVP, većinom glasova.</p> <p>4.Izjave o konfliktu interesa od strane kolegijalnih razmatrača se dostavljaju GAKV-u, po istom postupku iz tače 3 i 4 ovog člana.</p>

5. Deklaratat e Konfliktit të interesit duhet të bëhen publike duke u vendos si pjesë e veçantë në UK-të dhe PKK-të e botuara.

Neni 16
Aprovimi i UK-ve dhe PKK-ve

1. UK miratohet me vendim nga Ministri i Shëndetësisë;

2. UK-të të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ dhe nuk procedohen përmes KKUPK-së nuk aprovohen nga Ministria e Shëndetësisë;

3. Pas miratimit nga Ministri i Shëndetësisë, UK dhe PKK publikohen në faqen zyrtare të MSh-së dhe botohen;

4. Vendimin për revokim dhe revidim të UK-ve dhe PKK-ve e bën Ministri i Shëndetësisë, me propozim të KKUPK.

Neni 17
Procesi i PKK-ve

